



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 20.02.2025

Nr: 128

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN
ME NR. 22 ID, DATË 18.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË
PARTISË DEMOKRATIKE**

Sot më datë 20.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKES: Partia Demokratike

SUBJEKT: **Z. Pjerin Ndreu**
Kryetar në Bashkinë Lezhë

OBJEKT: Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara nga neni 91 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator nëpërmjet shpalljes së procedurave të prokurorit për sistemimin dhe asfaltin e Rrugëve Rurale në administrim të Bashkisë Lezhë

BAZA LIGJORE: Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator,

K O N S T A T O J :

Partia Demokratike, ka paraqitur denoncimin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, më datë 18.02.2025, nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail.

Denoncimi është regjistruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 22 ID, në datën 18.02.2025.

Data: 20.02.2025

Nr: 128
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin me nr. 22 ID, datë 18.02.2025 të regjistrit të denoncimeve, të Partisë Demokratike”

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon:

“Partia Demokratike ka marrë dijeni se Bashkia Lezhë ka shpallur procedurat e prokurorimit për sistemimin dhe asfaltimin e rrugëve rurale në administrim të Bashkisë Lezhë para fushatës zgjedhore.”

Nga sa më sipër çmohet, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
 - Z. Pjerin Ndreu, Kryetar për Bashkinë Lezhë.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI